

Në përgjithësi, me prind-ër duhet të kuptohet: bartësja, bartësi apo bartësit e autoritetit prindëror apo çdo përfaqësues-e tjetër ligjor-e.

Një bashkëpunim i mirë midis shkollës dhe familjes është i nevojshëm që shkollimi i nxënësit të bëhet në mënyrë sa më të qetë që të jetë e mundur. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, agjenda është një mjet i privilegjuar i komunikimit reciprok midis shkollës dhe familjes.

Forma, natyra dhe cilësia e vërejtjeve të shënuara në agjendë duhet të shikohen me vëmendje të veçantë. Dialogu mundëson komunikimin në mënyrën më të plotë e më të hollësishme lidhur me shkollimin e nxënësit. Përshkrimi, më poshtë, i përgjegjësive të secilës e secilit ka për objektiv mbështetjen e këtij komunikimi.

Përgjegjësitë e nxënësit

Nxënësi e sjell agjendën e tij çdo ditë në shkollë. Ai-ajo shënon aty detyrat e tij-saj dhe e mban atë me kujdes. Sapo në agjendë bëhet një shënim, nxënësi ua paraqet atë mësuesve-eve dhe prindërve të tij. Në fund të javës, nxënësi ua paraqet agjendën prindërve, me qëllim që këta ta nënshkruajnë.

Përgjegjësitë e mësuesit-es

Mësuesi-ja ka përgjegjësi që të kërkojë që në agjendë të shënohen detyrat, informacionet e shkollës, si dhe lajmërimet për ngjarje të veçanta. Në faqet javore, ai-ajo vë në dukje rezultatet e vlerësimit dhe shënon informacione të rëndësishme mbi punën dhe sjelljen e nxënësit. Me nënshkrimin e prindërve, ai-ajo verifikon se ata-ato kanë marrë njohuri për informacionet e dhëna.

Përgjegjësitë e prindërve

Prindërit verifikojnë rregullisht nëse në të është bërë ndonjë shënim i ri. Çdo javë, me nënshkrimin e tyre, ata vërtetojnë se kanë marrë njohuri për detyrat, shënimet e shkollës dhe rezultatet e vlerësimit. Bashkë me fëmijën e tyre, nëse dëshirojnë, ata mund t'i hedhin rezultatet e vlerësimit në tabelat e rezultateve që ndodhen në faqet 125-127. Në faqet javore, ata përcjellin informacionet e duhura lidhur me fëmijën.

Zotimi i nxënësit

Mora njohuri për rregullat lidhur me agjendën dhe zotohem se do t'i zbatoj ato.

Nënshkrimi i nxënësit: _____

Zotimi i prindërve

Muarëm njohuri për rregullat lidhur me agjendën dhe zotohemi t'i zbatojmë ato dhe të kërkojmë zbatimin e tyre.

Nënshkrimi i njërit prej prindërve (apo prej përfaqësuesit-ses të tij-saj):

Faqet dyshe javore (faqet 14-93)

Përmes faqeve javore ruhet lidhja midis shkollës dhe familjes, gjatë tërë vitit, lidhur me temat vijuese: puna mësimore në klasë dhe jashtë kohës mësimore (detyrat), jeta në shkollë, informacionet e rëndësishme, rezultatet e vlerësimeve dhe sjellja e nxënësit.

Mësuesi-ja apo prindërit mund të kërkojnë në çdo kohë që të bëhet një takim, duke vënë një kryq në katrorin përkatës.

Puna shkollore jashtë kohës mësimore (faqe 8)

Qysh nga klasa 3P, mësuesit-et mund t'u japin nxënësve punë për ta bërë jashtë klase: detyra. Kjo faqe paraqet qëllimet e tyre dhe kuadrin ligjor në të cilin ato hyjnë.

Rezultatet e vlerësimit përmbledhës (faqet 125-127)

Këto faqe përfshijnë tabela që mundësojnë pasjen e një shikimi tërësor të rezultateve të nxënësit në secilën lëndë përgjatë tërë vitit shkollor. Në to gjendet edhe thelbi i kuadrin ligjor në fushën e vlerësimit përmbledhës.

Kontaktet e shkollës (faqe 2)

Në këtë faqe gjenden edhe emrat e mësuesve-eve, adresat dhe koha e lirë e tyre.

Mirëqënia – Bashkëjetesa (faqe 3)

Kjo faqe ka për objektiv të paraqesë burimet e brendshme të shkollës dhe ato jashtë saj, në rast problemi të çfarëdo lloji.

Rregullat e jetës së klasës, institucionit, shkollës (faqja 10 dhe ato vijuese)

Çdo klasë apo institucion shkollor mund të hartojë rregullat e veta të jetës në bashkësi, në përputhje me ligjin mbi arsimin e detyrueshëm dhe rregulloren e zbatimit të tij.

Mungesa, leja – procedura dhe formularët (faqet 9, 98 e vijueset)

Çdo mungesë duhet t'i njoftohet shkollës, po qe e mundur paraprakisht e, në të gjitha rastet, sa më shpejt që të jetë e mundur. Referojuni procedurës që ekziston në shkollë, të përshkruar në faqen 9.

Edukimi numerik (faqet 114-117)

Bashkëpunimi midis shkollës dhe familjes u mundëson nxënësve zhvillimin e aftësive numerike dhe përfitimin nga aspekte të shumta pozitive të mjeteve dhe shërbimeve numerike. Me këtë rast, faqet 114-115 «Ch@rte Éducation numérique» dhe faqja 116 «Utilisation de dispositifs numériques personnels» kanë për qëllim të inkuadrojnë përdorimin e këtyre mjeteve dhe shërbimeve në kontekstin e shkollës apo jashtë kohës shkollore. Faqja 117 «Accès numériques» mundëson krijimin e një liste me mjetet e ndryshme të vëna në dispozicion të nxënësit.

Qysh nga klasa 3P, mësuesit-et u japin nxënësve detyra për t'i bërë jashtë kohës së mësimit të parashikuar në orarin e mësimit.

Detyrat kanë për objektiv mëvetësimin dhe përgjegjësimin e nxënësve. Ato shërbejnë për të përforcuar njohuritë e mara në klasë.

Ato mund të bëhen prej nxënësve pa ndihmën e të tjerëve.

Përgjegjësia e shkollës dhe mësuesve-eve

Llojet e detyrave të dhëna prej mësuesve-eve të klasave të ndryshme të institucionit shkollor janë të harmonizuara. Drejtorja i kushton vëmendje njësimin të praktikave.

Kur disa mësues-e ndërhyjnë në të njëjtën klasë apo pranë të njëjtit grup nxënësish, trupi pedagogjik bashkërendohet sa u përket sasisë dhe shpeshtësisë së detyrave.

Detyrat përgatiten në klasë dhe verifikohen rregullisht prej mësuesit-es; ato njoftohen të paktën dy ditë para.

Nuk jepet asnjë detyrë për të hënë, ditët e lejeve dhe pushimet shkollore.

Në rast mungese të një nxënësi-eje, mësuesit-et kujdeset-en që nxënësi të ketë informacionet dhe materialin që do t'i mundësojë plotësimin e boshllëqeve të shkaktuara nga mungesa në shkollë.

Përgjegjësia e nxënësit dhe prindërve të tij

Prindërit i krijojnë fëmijës kushtet e favorshme për bërjen e detyrave.

Nxënësit u përmbahen porosive të mësuesve-eve lidhur me detyrat.

Në rast mungese, nxënësi dhe prindërit e tij përpiqen të marrin materialin, porosinë dhe informacionet e duhura për kryerjen e punës së munguar.

Komunikimi

Në fillim të vitit të ri shkollor, mësuesit-et u bëjnë të ditur prindërve pritshmëritë e tyre lidhur me detyrat.

Gjatë vitit shkollor, nëse gjendja e nxënësit lidhur me detyrat e kërkon, çelet një dialog lidhur me këtë temë, me nismën e prindërve ose të trupit mësuesor.

Shkolla siguron, në bashkëpunim me prindërit, shkollimin e fëmijëve. Ajo mbështet prindërit në kryerjen e detyrës së tyre edukative.

Shkëmbimi i rregullt i informacioneve të rëndësishme dhe bashkëpunimi konstruktiv midis shkollës dhe familjes janë thelbësore. Ato kontribuojnë në mbështetjen e përparimit të nxënësit. Ato u bëjnë të mundur gjithashtu që të mendojnë sëbashku për të gjetur zgjidhjet më të mira të mundura për shkollimin e tij.

Familjet kanë raste të ndryshme për t'u informuar dhe për të shkëmbyer mendime për sa ngjet në shkollë. Kështu, prindërit ftohen çdo vit të marrin pjesë në një seancë kolektive informimi, gjatë së cilës takojnë mësuesit-et e fëmijës së tyre. Prindërit mund të kërkojnë edhe takime individuale.

Faqja 3 e fletushkës « Bien être – Bien vivre » ka për objektiv të informojë nxënësit dhe familjet e tyre për faktin se ekzistojnë njerëz referentë në shkollë dhe jashtë shkollës, mbi të cilët mund të mbështeten në rast nevojë. Ata janë atje për të informuar, ndihmuar, mbështetur, këshilluar dhe orientuar nxënësit dhe familjet e tyre.

Në rast pyetjesh, shqetësimesh apo kur shfaqen vështirësi, njerëzit referentë që duhen kontaktuar së pari janë mësuesi-ja e interesuar dhe mësuesi-ja kujdestar-e. Mund të kontaktohen edhe punonjës-e të tjerë-a të shkollës:

- Ndërmjetësuesja ose ndërmjetësuesi (médiatrice ou médiateur);
- Infermierja ose infermieri;
- Psikologu;
- Psikomotricienja ose psikomotricieni;
- Logopedistja ose logopedisti;
- Punonjësja ose punonjësi shoqëror i mjedisit shkollor, për shembull edukatorja ose edukatori;
- etj.

Po qe nevoja, prindërit mund t'u drejtohen edhe anëtarëve të Këshillit drejtues: dekanes ose dekanit, drejtoreshës ose drejtorit.

Në fund, nëse prindërit çmojnë se të gjitha perçapjet e bëra prej tyre brenda institucionit shkollor nuk sjellin përgjigje të kënaqshme për vështirësitë e hasura prej fëmijës së tyre, ata mund të kontaktojnë Departamentin e formimit, rinisë dhe kulturës (Département de la formation, de la jeunesse et de la culture, DFJC). Në këtë rast, Departamenti mund të ofrojë shërbimet e veta të vullnetit të mirë dhe të propozojë pajtimin midis palëve, për të forcuar lidhjen shkollë-familje dhe nxisë kërkimin e një zgjidhjeje të mirë për nxënësin.

Më tepër hollësi keni në sitin tonë të Internetit:

*www.vd.ch/scolarité > Relations entre l'école et la famille
ose në sitin e Internetit të institucionit shkollor.*

